



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.599/8 prot

Datë 23.04.2024

V E N D I M

Nr. 394/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.04.2024 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-93846-01-25-2024, me objekt: “*Riparim-mirëmbajtje e ashensorëve të QSUNT*”, për 24 muaj” me fond limit 37 190 475,28 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 12.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza”.

Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza” me adresë: “Rruga e Dibrës” Nr. 372, Tiranë.

Ankimues: BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK, përkatësisht me NUIS L01325010Q dhe L92202031A, me adresë: Njesia Administrative Nr.5, Rruga Hasan Vogli, Zona Kadastrale 3292, Nr. Pasurie 68/68-d2, Selitë, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.01.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-93846-01-25-2024, me objekt: “Riparim-mirëmbajtje e ashensorëve të QSUNT’, për 24 muaj” me fond limit 37 190 475,28 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 12.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

II.2. Në datën 29.02.2024, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, janë njoftuar elektronikisht për vlerësimin e ofertave si më poshtë vijon:

“Climacasa” SHPK	27.891.040 lekë, skualifikuar
“Altec” SHPK	28.563.240 lekë, skualifikuar

BOE "Class Ashensor" SHPK & "Vertikus" SHPK, është njoftuar për arsyet e skualifikimit të tij si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

"Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta e BOE "Class" dhe "Vertikus" nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit dhe specifikimeve teknike të publikuar në sistemin e prokurimit elektronik në faqen e APP-se, në mbështetje të "Ligjit për Prokurimin Publik" 162, datë 23.12.2020, nenit 80, nenit 90, të VKM 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, neni 25, neni 82 pika 2.

Së pari; *Ne dokumentacionin e paraqitur në SPE nga BOE "CLASS" sh.p.k. dhe "Vertikus" shpk është paraqitur shtojca "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", i plotësuar në pjesën III "Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit", gërma "B" Deklaratë "Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme" për realizimin e kontratës objekt prokurimi, në përmbushje për plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, pika 2.3.3, pika 2.3.4 dhe 2.3.7 ku kërkohet:*

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqese, staf të mëposhtëm:

- 1 (një) Inxhinier Mekanik, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomën përkatëse si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

- 1 (një) Inxhinier Elektrik, i punësuar në këtë shoqëri/ ose të ketë kontratë bashkëpunimi me shoqërinë. (Për Inxhinierin Elektrik duhet të paraqesë: kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomën përkatëse si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave - nëse është i punësuar pranë shoqërisë/ ose kontratën e bashkëpunimit dhe diplomën përkatëse nëse është me kontratë bashkëpunimi) Shenim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Në rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqese dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

Dhe pika

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf për kryerjen e shërbimit, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, me dokument certifikues (deftese dhe/ose diplome dhe/ose dëshmi kualifikimi) për profilin profesional të kërkuar, lëshuar nga institucione publike apo private të akredituara për certifikimin e punonjësve sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 2 Punonjës Elektriciste

- 2 Punonjës Mekanik

- 2 Punonjës Teknikë Ashensorësh

Shenim: Ky kriter ne fazen e ofertimit te operatoreve ekonomik do te konsiderohet i permbushur me dorezimin/paraqitjen e formularit permbledhes te vetdeklarimit sipas shtojces 9 te DST. Ne rastet kur OE do te shpallet fitues duhet te paraqese dokumentacionin provues sipas ketij kriteri.

2.3.7 Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmoje se ka ne pronesi ose qira mjetet e pajisjet teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si me poshte:

Lloji i makinerise (pajisjes) Njesia Sasia Statusi

Kamioncin me kapacitet mbajtes deri 3.5 ton cope 1 Në pronësi ose me qera

Gjenerator cope 1 Në pronësi ose me qera

Shkalle te levizshme cope 2 Në pronësi ose me qera

Trapan cope 2 Në pronësi ose me qera

Gur fresibel cope 2 Në pronësi ose me qera

Saldatrice cope 1 Në pronësi ose me qera

Pomp zhytесе cope 1 Në pronësi ose me qera

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

c) Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).

d) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.

Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor. e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje.

Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

BOE "Class" dhe "Vertikus" i kanë deklaruar pjesërisht stafin përbërës të tyre por nuk kanë përcaktuar qartë nëpërmjet nr. të diplomës, dëshmisë së kualifikimit, librezë pune etj, sic është kërkuar në kriteret 2.3.3 dhe 2.3.4 dhe mjetet e deklaruar nuk janë plotësuar me të dhënat që kërkohen në pikë 2.3.7 nga gërma "a" deri te gërma "e".

Sa më sipër, deklarata e sipërcituar nuk është e plotë dhe nuk i jep mundësi autoritetit kontraktor mbi verifikimin e nevojshëm mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik. Këto shtojca janë standarte dhe duhet të plotësohen me përpikmëri në përputhje me formatin e miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, për më tepër në vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1237/2023, KPP është shprehur se “Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”

KVO gjykon se në rastin konkret jemi në kushtet e mosplotësimin në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt prokurimi dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese dhe si pasojë sjell mospërmbushjen e kriterëve 2.3.3, 2.3.4 dhe 2.3.7 të kapacitetit teknik. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë Autoritetit Kontraktor QSU “Nënë Tereza” sipas parashikimeve të nenit 75 të LPP.

Në rregullat e prokurimit DST, Kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë” Seksioni 1, Hartimi i ofertës, në pjesën e përgjithshme pika 2 germa a) thuhet shprehimisht; “Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit do të çojë në refuzimin e Ofertës.

Përsa cituam më lart shtojca mbi deklaratën e kriterëve të përgjithshme do të konsiderohet e paplotë dhe për rrjedhojë e pavlefshme.

Së dyti AK, në dokumentet e tenderit në shtojcën 8, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” pika 2.2.2 citon:

“Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.”

Nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se OE “Ventricus” ka paraqitur bilacin e viteve 2020, 2021 dhe 2022 **të pashoqëruar me vulën Autoritetit përkatës Dega e Tatim Taksave.**

Mungesa e një elementi të tillë në bilanc, sjell mospërmbushjen e kriterit 2.2.2 konkretisht certifikimin nga autoritetet përkatëse. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 80 , nenit 92 pika 3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik”, dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 pika 2, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Së treti, operatorëve ekonomik, në përmbushje të kapaciteti teknik në dokumentet e tenderit, në pikën 2.3.2 u është kërkuar pajisja me licencën profesionale NS- 3 Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues), sipas legjislacionit në fuqi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, OE “Class” shpk ka dorëzuar licencën e kërkuar me nr. NZ.6534/3 **dhe me afat vlefshmërie deri me datë 30.10.2024.**

Sjellim në vëmendje, që procedura e prokurimit me objekt “Riparim-mirëmbajtje e ashensorëve të QSUNT”, me nr. REF-93846-01-25-2024, e llojit Marrëveshje Kuadër, është me afat 24 muaj.

Paraqitja e licences me afat vlefshmërie deri në tetor të këtij viti, nuk krijon bindjen dhe nuk jep garanci AK, për përmbushjen me sukses të kontratës së shpallur prej nesh.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 80 , nenit 92 pika 3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik”, dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 pika 2, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.”

II.3. Në datën 01.03.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e anulimit të procedurës së mësipërme të prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 08.03.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 599/2024 protokoll dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3884 e BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK, si dhe ankesa me nr. 599/1 prot., dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3883 e këtij bashkimi operatorësh, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-93846-01-25-2024, me objekt:

“Riparim-mirëmbajtje e ashensorëve të QSUNT”, për 24 muaj” me fond limit 37 190 475,28 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 12.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesave të sipërcituara, u konstatua, se objekti i tyre lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK.

II.5. Në përputhje me nenin 112 *“Veprimet paraprake”* të Ligjit nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, me marrjen e ankesës, (dy ankesat janë të njëjta, pra është një ankesë) Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 599/2, datë 09.03.2024, me arsyet e skualifikimit që BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 599 prot., dhe nr. 599/1 prot., datë 08.03.2024.

II.6. Me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës së BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK pranë KPP-së, nëpërmjet shkresës nr. 599/4 prot., datë 21.03.2024, me objekt: *“Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni dhe dokumentacioni KPP-së lidhur me ankesën e BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK”,* Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të sjellë në KPP, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave; të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së lartpërmendur.

II.7. Në datën 08.04.2024, është protokolluar në KPP me nr. 599/5 prot., shkresa e autoritetit kontraktor 844/4 prot., datë 05.05.2024, me objekt: *“Kthim - përgjigje mbi Formularin e Asnesës të administruar me nr. A/2024/3883 ankim elektronik, nga BOE “Class Ashensor” SHPK me NUIS L01325010Q dhe “Vertikus” SHPK, me NUIS L92202031A”,* drejtuar BOE ankimues dhe për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik. Referuar kësaj shkrese rezulton, se KSHA e ka refuzuar ankesën me argumentin se: *“[...] Nga verifikimet e kryera për administrimin zyrtarisht të ankesës në regjistrin e protokollit pranë autoritetit kontraktor QSU “Nënë Tereza”, konstatohet, se bashkimi i operatorëve ekonomikë (BOE) ankues nuk e ka paraqitur ankesën edhe në autoritetin kontraktor, sikurse detyrojnë dispozitat ligjore dhe nënligjore. [...]”*

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK, se:

“Së pari; Ne dokumentacionin e paraqitur në SPE nga BOE “CLASS” sh.p.k. dhe “Ventrikus” shpk është paraqitur shtojca “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, i plotësuar në pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma “B” Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” për realizimin e kontratës objekt prokurimi, në përmbushje për plotesimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, pika 2.3.3, pika 2.3.4 dhe 2.3.7 ku kërkohet:

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqese, staf të mëposhtëm:

- 1 (një) Inxhinier Mekanik, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomën përkatëse si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

- 1 (një) Inxhinier Elektrik, i punësuar në këtë shoqëri/ ose të ketë kontratë bashkëpunimi me shoqërinë. (Për Inxhinierin Elektrik duhet të paraqesë: kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomën përkatëse si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave - nëse është i punësuar pranë shoqërisë/ ose kontratën e bashkëpunimit dhe diplomën përkatëse nëse është me kontratë bashkëpunimi) Shenim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorezimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Në rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqese dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

Dhe pika

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf për kryerjen e shërbimit, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, me dokument certifikues (deftese dhe/ose diplome dhe/ose dëshmi kualifikimi) për profilin profesional të kërkuar, lëshuar nga institucione publike apo private të akredituara për certifikimin e punonjësve sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 2 Punonjës Elektriciste

- 2 Punonjës Mekanik

- 2 Punonjës Teknikë Ashensorësh

Shenim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorezimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Në rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqese dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

2.3.7 Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose qira mjetet e pajisjet teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë:

Lloji i makinerise (pajisjes) Njesia Sasia Statusi

Kamioncin me kapacitet mbajtes deri 3.5 ton cope 1 Në pronësi ose me qera

Gjenerator cope 1 Në pronësi ose me qera

Shkalle te levizshme cope 2 Në pronësi ose me qera

Trapan cope 2 Në pronësi ose me qera

Gur fresibel cope 2 Në pronësi ose me qera

Saldatrice cope 1 Në pronësi ose me qera

Pomp zhytесе cope 1 Në pronësi ose me qera

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

c) Për mjetet e deklaruara që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).

d) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.

Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor. e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje.

Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

BOE “Class” dhe “Ventricus” i kanë deklaruar pjesërisht stafin përbërës të tyre por nuk kanë përcaktuar qartë nëpërmjet nr. të diplomës, dëshmisë së kualifikimit, librezë pune etj, sic është kërkuar në kriteret 2.3.3 dhe 2.3.4 dhe mjetet e deklaruara nuk janë plotësuar me të dhënat që kërkohen në pikë 2.3.7 nga gërma “a” deri te gërma “e”.

Sa më sipër, deklarata e sipërcituar nuk është e plotë dhe nuk i jep mundësi autoritetit kontraktor mbi verifikimin e nevojshem mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik. Këto shtojca janë standarte dhe duhet të plotësohen me përpikmëri në përputhje me formatin e miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, për më tepër në vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1237/2023, KPP është shprehur se “Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme

për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”

KVO gjykon se në rastin konkret jemi në kushtet e mosplotësimin në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt prokurimi dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese dhe si pasojë sjell mospërmbushjen e kriterëve 2.3.3, 2.3.4 dhe 2.3.7 të kapacitetit teknik. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë Autoritetit Kontraktor QSU “Nënë Tereza” sipas parashikimeve të nenit 75 të LPP.

Në rregullat e prokurimit DST, Kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë” Seksioni 1, Hartimi i ofertës, në pjesën e përgjithshme pika 2 germa a) thuhet shprehimisht; “Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit do të çojë në refuzimin e Ofertës.

Përsa cituam më lart shtojca mbi deklaratën e kriterëve të përgjithshme do të konsiderohet e paplotë dhe për rrjedhojë e pavlefshme..”,

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1/a, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

III.1.2. Në shtojcën 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.3., 2.3.4 dhe 2.3.7, të dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit, të publikuara në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterëve si vijon:

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë, **staf të mëposhtëm:**

- **1 (një) Inxhinier Mekanik**, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomën përkatëse si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

- **1 (një) Inxhinier Elektrik**, i punësuar në këtë shoqëri/ ose të ketë kontratë bashkëpunimi me shoqërinë.

(Për Inxhinierin Elektrik duhet të paraqesë: kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomën përkatëse si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave - nëse është i punësuar pranë shoqërisë/

ose kontratën e bashkëpunimit dhe diplomën përkatëse nëse është me kontratë bashkëpunimi)

Shenim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatorëve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Në rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf për kryerjen e shërbimit, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, me dokument certifikues (deftese dhe/ose diplome dhe/ose dëshmi kualifikimi) për profilin profesional të kërkuar, lëshuar nga institucione publike apo private të akredituara për certifikimin e punonjësve sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- **2 Punonjës Elektriciste**
- **2 Punonjës Mekanik**
- **2 Punonjës Teknikë Ashensorësh**

Shenim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatorëve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Në rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

2.3.7. Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose qira mjetet e pajisjet teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë :

<i>Lloji i makinerise (pajisjes)</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Statusi</i>
<i>Kamioncin me kapacitet mbajtes deri 3.5 ton</i>	<i>cope</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Gjenerator</i>	<i>cope</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Shkalle te levizshme</i>	<i>cope</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Trapan</i>	<i>cope</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Gur fresibel</i>	<i>cope</i>	<i>2</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Saldatrice</i>	<i>cope</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
<i>Pomp zhytese</i>	<i>cope</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi;

ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

c) Për mjetet e deklaruara që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).

d) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

III.1.2. Në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>

Emri, Mbiemri _____
Firma _____
Vula _____
Data e dorëzimit të deklaratës _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se secili prej operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në bashkimin e përkohshëm BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK, në përmbushje të kriterëve sa më sipër cituar, kanë dorëzuar Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 9), të plotësuar nga secili prej tyre, ku në Deklaratën për disponimin e punonjësve dhe mjeteve, është deklaruar si vijon:

Operatori ekonomik “Class Ashensor” SHPK ka deklaruar:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u> Po [X] Jo []

Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Nëse, po, numri i punonjësve:

OE“CLASS ASHENSOR” SHPK disponon te punesuar ne stafin e vet 10 punonjes dhe nëse do te jem operatori i suksesshem ne kete procedure prokurimi do ta dorezoje gjithë dokumentacionin e kërkuar nga AK-ja ne piken 2.3.5 te shtojcës 8 te DST.

Profili i punonjësve dhe Specialitetet qe disponoj :

Inxhinier Mekanik-
 Inxhinier Elektrik -
 Inxhinier Ndërtimi -
 Punonjës Elektricitist -
 Punonjës Mekanik -
 Punonjës Teknikë Ashensorësh -
 Punonjës Teknikë Ashensorësh -
 Punonjës Elektronik-
 Punonjës IT -
 PunonjësModernizim/Modifikim Te Ashensorve
 Punonjës Ndihmes
 Punonjës Ndihmes

Makineri e mjete

Po [X] Jo []

Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:

OE“CLASS ASHENSOR” SHPK disponon ne pronësi dhe me qira mjetet dhe pajisjet e specifikuara si me poshtë dhe nëse do te jem operatori i suksesshem ne kete procedure prokurimi do ta dorezoje gjithë dokumentacionin e kërkuar nga AK ne piken 2.3.7 te shtojcës 8 te DST.

Kamioncin me kapacitet mbajtes deri 3.5 ton cope me targe . Ky mjet ndodhet ne kete Adresë: peskuqan .

Shkalle te levizshme 2 cope
 Trapan 1 cope m18fhiwf12-0x
 Trapan 1 cope M18fmdp-502c
 Trapan 1 cope m18fpp4z-503b
 Gur fresibel 2 cope m18fpp4z-503b
 Pomp zhytесе 1 cope Petrolo 4P/3
 Gjenerator 1 cope
 Saldatrice 1 cope
 Keto mjete dhe pajisje ndodhen me këtë adresë: Njesia Adminstrative Nr.5, Rruga Hasan Vogli, Zona Kadastrale 3292, Nr. Pasurie 68/68-d2, Selite, Tiranë.

Operatori ekonomik “Vertikus” SHPK ka deklaruar:

B: DEKLARATË**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u> Po [<input checked="" type="checkbox"/>] Jo [<input type="checkbox"/>]

Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	<p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>OE“VERTIKUS” SHPK,disponon te punesuar ne stafin e vet 8 punonjes dhe nëse do te jem operatori i suksesshem ne kete procedure prokurimi do ta dorezoje gjithë dokumentacionin e kërkuar nga AK-ja ne piken 2.3.5 te shtojcës 8 te DST.</p> <p>Profili i punonjësve qe disponoj :</p> <p>Inxhinier Mekanik- Punonjes elektrikist- Punonjës Elektriciste- Punonjës Mekanik- Punonjës Mekani- Punonjës teknik ashensoresh- Punonjës teknik ashensoresh- Punonjës teknik ashensoresh- Administrator - Financier- Asistente zyre-</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [<input checked="" type="checkbox"/>] Jo [<input type="checkbox"/>]</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/> <p>OE“VERTIKUS” SHPK, disponon ne pronësi dhe me qira mjetet dhe pajisjet e specifikuara si me poshtë dhe nëse do te jem operatori i suksesshem ne kete procedure prokurimi do ta dorezoje gjithë dokumentacionin e kërkuar nga AK ne piken 2.3.7 te shtojcës 8 te DST.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Automjet per transport 2 cope me targe , dhe - Shkalle te levizshme 2 cope - Trapan 2 cope - Gur fresibel 2 cope - Saldatrice 1 cope <p>Keto mjete dhe pajisje ndodhen me këtë adresë: Rruga “”, Tiranë.</p>
--	---

III.1.4. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.1.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.6. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarinimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislati në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.8. Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “c” dhe “ç” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislatit përkatës; dhe/ose
- ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[...]”

III.1.9. Referuar frymës së legjislatit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se secili prej operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në bashkimin e përkohshëm kanë dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku rezulton, se kanë plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon ky formular, specifikisht kanë deklaruar personelin dhe stafin teknik si dhe mjetet e pajisjet për kryerjen e shërbimit sipas përcaktimeve të parashikuara në kriteret e veçanta të kualifikimit si më sipër cituar. Për më tepër, autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit për këtë procedurë prokurimi dhe përpara publikimit të njoftim-fituesit, nuk ka zbatuar përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 26 të VKM, ku thuhet se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.** Gjithashtu nuk ka kërkuar asnjë sqarim apo informacion në përputhje me pikën 7 të nenit 26 të VKM, sipas së cilës në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t’i kërkojë sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në rastin konkret autoriteti kontraktor nuk i ka kërkuar ofertuesit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2 shkronjën h) *operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); shkronjën i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti,* për arritjen e një përfundimi të saktë, që bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes nuk i plotëson këto kriteret.

Gjithashtu, sipas shtojcës 8 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Pjesa II, Pika A-Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, është përcaktuar që referencat për këto lloj deklaratah do të bëhen në rastet kur janë të zbatueshme: “Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni”. Pra, Komisioni gjykon, se ka dy mënyra se si autoriteti kontraktor mund të marrë këto dokumente,

e para në bazë të të dhënave të aksesueshme shtetërore nëse është i disponueshëm dhe e dyta **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.**

Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, duhet t'i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor dhe kërkesën për **dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.**

Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti/enti kontraktor ai që duhet t'i kërkojë **ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285.** Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë.

Për sa më lart, pretendimet e BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK qëndrojnë.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK, se:

“Së dyti AK, në dokumentet e tenderit në shtojcën 8, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” pika 2.2.2 citon:

“Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.”

*Nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se OE “Ventrikus” ka paraqitur bilacin e viteve 2020, 2021 dhe 2022 **të pashoqëruar me vulën Autoritetit përkatës Dega e Tatim Taksave.***

Mungesa e një elementi të tillë në bilanc, sjell mospërmbushjen e kriterit 2.2.2 konkretisht certifikimin nga autoritet përkatëse. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 80, nenit 92 pika 3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik”, dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 pika 2, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit”,

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8, pika 2.2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

III.2.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) Komisioni konstatoi, se në funksion të plotësimit të kriterit 2.2.2 të mësipërm, operatori ekonomik “Ventrikus” SHPK, anëtar i BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK ka dorëzuar në SPE shkresën me nr. 2525 prot., datë 09.02.2024 me objekt: “Kthim - përgjigje”, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, drejtuar shoqërisë “Vertikus” SHPK, me përmbajtjen si vijon:

“Në përgjigje të kërkesës suaj me numër çështje E0001211501, datë 07.02.2014, po ju vëmë në dispozicion në formatin PDF, kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj në sistemin informatik tatimor, për vitet:

- Viti 2020 të dorëzuar elektronikisht pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me datë 18.03.2021.
- Viti 2021 të dorëzuar elektronikisht pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë format i ndryshuar me datë 31.03.2021 me datë 18.03.2021.
- Viti 2022 të dorëzuar elektronikisht pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me datë 18.03.2023.”

Bashkëngjitur kësaj shkrese, shoqëria “Vertikus” SHPK ka paraqitur në SPE pasqyrat financiare të tre viteve të sipërcituara.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.4. Në nenin 21, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, thuhet shprehimisht:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.5. Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;
- c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor. [...].

Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

III.2.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet ekonomike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në këtë kuadër KPP, vëren se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit krahas paraqitjes nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm, përveç kërkesave të tjera, edhe kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2020,2021,2022), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve.

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Vertikus" SHPK konstatohet, se ky i fundit ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) shkresën me nr. 2525 prot., datë 09.02.2024, me objekt: "Kthim - përgjigje", lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, drejtuar shoqërisë "Vertikus" SHPK si dhe pasqyrat financiare për vitet 2020, 2021 dhe 2022.

Referuar kërkesës së autoritetit kontraktor, kriterit 2.2.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, kapacitetit ekonomik dhe financiar, si dhe pretendimeve të BOE ankimues, bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", nuk ka një koncept të certifikimit të bilanceve nga organet tatimore në kuptim të ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", për rrjedhojë, nuk ka një akt që mund të kërkohet apo të dorëzohet. Ndërkohë Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 82 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:*

i. "Devijimi" është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;
ii. "Rezervimi" është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe

iii. "Mospranimi" është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë", autoriteti kontraktor ka në dispozicion momentin procedural për kryerjen e verifikimeve apo kërkimin e sqarimeve operatorit ekonomik.

Akoma më tej, Komisioni gjykon, se autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike të operatorëve ekonomikë, mund të kërkojë paraqitjen e

dokumenteve sipas përcaktimit të nenit 43 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër, pretendimet e BOE ankimues qëndrojnë.

III.3. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK, sipas të cilës: **“Së treti, operatorëve ekonomikë, në përmbushje të kapacitetit teknik në dokumentet e tenderit, në pikën 2.3.2 u është kërkuar pajisja me licencën profesionale NS- 3 Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues), sipas legjislacionit në fuqi.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, OE “Class” shpk ka dorëzuar licencën e kërkuar me nr. NZ.6534/3 **dhe me afat vlefshmërie deri me datë 30.10.2024.**

Sjellim në vëmendje, që procedura e prokurimit me objekt “Riparim-mirëmbajtje e ashensorëve të QSUNT”, me nr. REF-93846-01-25-2024, e llojit Marrëveshje Kuadër, është me afat 24 muaj.

Paraqitja e licences me afat vlefshmërie deri në tetor të këtij viti, nuk krijon bindjen dhe nuk jep garanci AK, për përmbushjen me sukses të kontratës së shpallur prej nesh.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 80 , nenit 92 pika 3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik”, dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 pika 2, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.2, e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga autoriteti kontraktor, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë:

2.3.2 Licenca profesionale, Operatori Ekonomik duhet të disponojë Licencën e shoqërisë e vlefshme për kategorinë: NS-3 A Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues), sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se shoqëria “Class Ashensor” SHPK, anëtare e BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar Licencë NZ.6534/3, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale për Shoqëritë që Ushtrijnë Veprimtari Ndërtuese Zbatimi, për shoqërinë “Class Ashensor” SHPK, me shënimin: “Kjo licencë është e vlefshme deri më 30.10.2024.” Në këtë licencë përfshihet edhe kategoria: “NS-3”, “A Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)”.

III.3.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, i ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

III.3.4. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, i VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikon shprehimisht se:

- Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*
- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose 41*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.3.5. Neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, i VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikon shprehimisht se:

- 1.Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*
- 2.Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.*

- 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

III.3.6. KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në datën e hapjes së ofertave, datë 12.02.2024, Licenca NZ.6534/3, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale për Shoqëritë që Ushtrjnë Veprimtari Ndërtuese Zbatimi për shoqërinë “Class Ashensor” SHPK, është e vlefshme, pasi vlefshmëria e saj është më 30.10.2024. Pra, në momentin e paraqitjes së ofertës, operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor, dokumentacion i cili plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në ligj. Fakti që afati i vlefshmërisë së licencës në fjalë përfundon pas afro 8 muajve që është zhvilluar procedura e prokurimit, nuk duhet të penalizojë subjektin, duke i kufizuar atij të drejtën për të marrë pjesë dhe rrjedhimisht për t'u kualifikuar në procedurën e prokurimit. Pajisja e shoqërisë me licencën përkatëse kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Është detyrim ligjor i autoritetit kontraktor të kërkojë gjatë periudhës së realizimit të kontratës, zbatimin e detyrimeve nga ana e operatorit ekonomik me të cilin është lidhur kontrata, sië përcaktohen në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. Në rast se konstatohet mosrespektim i këtyre detyrimeve, autoriteti kontraktor duhet të veprojë në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik dhe Kodin Civil.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.4. Me shkresën e autoritetit kontraktor 844/4 prot., datë 05.05.2024, me objekt: “Kthim - përgjigje mbi Formularin e Asnkesës të administruar me nr. A/2024/3883 ankim elektronik, nga BOE “Class Ashensor” SHPK me NUIS L01325010Q dhe “Vertikus” SHPK, me NUIS L92202031A”, drejtuar BOE ankimues dhe për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar në KPP me nr. 599/5 prot, datë 08.04.2024, rezulton, se KSHA e ka refuzuar ankesën me argumentin se: “[...] Nga verifikimet e kryera për administrimin zyrtarisht të ankesës në regjistrin e protokollit pranë autoritetit kontraktor QSU “Nënë Tereza”,

konstatohet se bashkimi i operatorëve ekonomikë (BOE) ankues nuk e ka paraqitur ankesën edhe në autoritetin kontraktor, sikurse detyrojnë dispozitat ligjore dhe nënligjore. [...]

Sa më sipër, vlen të theksojmë, se që në datën 27.10.2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka implementuar sistemin e Regjistrimit Elektronik të Ankesave, duke mundësuar tashmë për të gjithë operatorët ekonomikë, paraqitjen e ankesës në të njëjtën kohë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në rrugë elektronike. Me dorëzimin e ankesës në sistemin elektronik, në përputhje me afatet në ligjin 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, ankesa menjëherë konsiderohet e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, njëkohësisht në të dyja institucionet. Ankesa dhe e gjithë përmbajtja e saj është e aksesueshme nga autoriteti kontraktor, në Sistemin Elektronik të Ankesave.

Në këtë kuadër, nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, është kryer një cikël trajnimesh falas, në 12 qarqe të Shqipërisë, ku janë ftuar të marrin pjesë të gjitha institucionet të cilat zhvillojnë procedura prokurimi, si dhe operatorë ekonomikë, të cilët janë njohur mbi mënyrën e funksionimit dhe përdorimit të këtij sistemi. Akoma më tej, më datë 09.03.2024, Komisioni i Prokurimit Publik, përmes komunikimit elektronik zyrtar, e ka njoftuar autoritetin kontraktor për paraqitjen e ankesës së sipërpërmendur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për kryerjen e disa veprimeve procedurale në sistemin elektronik të ankesave, me qëllim zbatimin e procedurave ligjore.

Sa më sipër, BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK, ka paraqitur ankim në rrugë elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, sipas të gjitha kushteve formale dhe afateve të parashikuara ligjore, në lidhje me procedurën objekt-shqyrtimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-93846-01-25-2024, me objekt: “*Riparim-mirëmbajtje e ashensorëve të QSUNT*”, për 24 muaj”, me fond limit 37 190 475,28 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 12.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

2. Autoriteti kontraktor të shfuqizojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Class Ashensor” SHPK & “Vertikus” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

